



HIDROIZOLIM TARRACASH/ ÇATISH SISTEME MEMBRANASH TË LËNGSHME Sika®

APLIKIM I LEHTË, I SIGURT DHE I SHPEJTË

ZGJIDHJA E PËRKRYER PËR HIDROIZOLIMIN E TARRACAVE/ ÇATIVE

BUILDING TRUST



TABELA E PËRMBAJTJES



ZGJIDHJA MË E MIRË PËR HIDROIZOLIMIN E TARRACAVE/ ÇATIVE ME GJEOMETRI TË NDËRLIKUAR DHE JO VETËM!

Funksioni parësor që një konstruksion duhet të kryejë, është mbrojtja e njërvëzve dhe aktiviteteve të tyre nga mjedisi dhe kushtet e motit. Linja e parë e mbrojtjes është tarraca/ çatia.

Tarraca/ çatia duhet të ketë rezistencë afatgjatë ndaj ndikimeve të ndryshme, si ndryshimet e temperaturës, rrezatimi diellor, era, shiu, dëborë, etj. Nuk mjafton të sigurohet vetëm padepërtueshmëria e ujit në pjesën e brendshme të ndërtesës, pasi depëtimi i tij tek materialet e ndërtimit pakëson performancën e tyre dhe përshpejton konsumimin e tyre. Uji redukton performancën e çdo sistemi termoizolues, bllokun substancat korroduese dhe kontribuon tek oksidimi, ngrirja, etj. Sistemi i hidroizolimit që do të zgjidhet, është në çdo rast rezultat i kombinimit të faktorëve të ndryshëm teknikë-ekonomikë si në konstruksionet e reja, por edhe në punimet restauruese.

Sika® disponon në gamën e saj sisteme të ndryshme hidroizolimi, si:

- Membrana PVC (Sikaplan®)
- Membrana TPO (Sarnafil®)
- Membrana bituminoze (Sika® Bituseal T)
- Veshje/ shtresa çimentoje (Sikalastic®)
- Membrana të lëngshme (Sikalastic®, Sikafill®)

Në çdo rast, përzgjedhja e duhur për çdo projekt konkret përcaktohet pas një vlerësimi të hollësishëm të të gjithë kushteve, siç janë për shembull:

- Nënshtrësa (p.sh. beton, dru, metal, membrana bituminoze të vjetra, etj.)
- Përmasa dhe forma e tarracës (sipërfaqja në m², tarracë e sheshtë, tarracë e mbyllur, zbatimi arkitekturor, etj.)
- Përdorimi (tarracë me sisteme fotovoltaike, e gjelbër, për përdorim, për qarkullim të kufizuar ose pa qarkullim, etj.)
- Fuksionimi i ndërtesës (banesë, ndërtesë me zyra, aeroport, qendër shpërndarjesh, etj.)
- Numri i detajeve dhe depërtimeve në sipërfaqen e tarracës/ çatisë, etj.

Në këtë broshurë prezantohen karakteristikat, avantazhet dhe sugjerimet e sistemeve për hidroizolim me membrana të lëngshme Sika, ndërsa jepet njëkohësisht orientim i saktë për sa i përket përzgjedhjes së duhur bazuar në kushtet e veprës dhe kërkesave për performancë.

■ MEMBRANA TË LËNGSHME SIKA	4
■ APLIKIMI I SISTEMEVE TË MEMBRANAVE TË LËNGSHME SIKA	6
■ PERFORMANCA TEKNOLOGJIKE E SISTEMEVE TË MEMBRANAVE TË LËNGSHME	10
■ TARRACA TË FTOHTA ME MEMBRANA TË LËNGSHME HIDROIZOLIMI	12
■ TEKNOLOGJI & PRODUKTE	14
■ SISTEME MEMBRANASH TË LËNGSHME Sika®	18
- SISTEM ME KËRKESA KONVENCIONALE	18
- SISTEM ME KËRKESA TË LARTA	19
- SISTEM ME PERFORMANCË TË LARTË	20
- SISTEM ME PERFORMANCË TË SHKËLQYER	21
- SISTEMET SIKALASTIC® MTC	22
■ SISTEME PËR TARRACAT/ ÇATITË E EKSPOZUARA	24
■ SISTEME PËR TARRACAT/ ÇATITË E GJELBRA	26
■ SISTEME PËR RESTAURIMIN E TARRACAVE/ÇATIVE EKZISTUESE	28
■ MODIFIKIMI I DETAJEVE ME MEMBRANAT E LËNGSHME SIKA	30
■ PROCEDURAT E APLIKIMIT TË MEMBRANAVE TË LËNGSHME SIKA	32
■ PRODUKTE / VEGLA NDIHMUESE	34
■ REFERENCA PROJEKTESH	40

MEMBRANA TË LËNGSHME

HIDROIZOLIM TARRACE/ÇATIE PA TEGELA, APLIKIM I LEHTË, ZGJIDHJE E SHKËLQYER DHE REZISTENTE PËR TARRACA/ÇATI TË TË GJITHA LLOJEVE



KU KA MË SHUMË MUNDËSI DËSHTIMI I HIDROIZOLIMIT TË NJË TARRACE/ ÇATIE?

TEK TEGELAT DHE DETAJET! Shmangia e krijimit të tegelave apo bashkimeve gjatë hidroizolimit, mund të ofrojë vetëm avantazhe për tarracat dhe çatitë me gjeometri të ndërlikuar. Kjo gjë është tashmë e mundur me përdorimin e membranave të lëngshme Sika.

ZGJIDHJA: MEMBRANA TË LËNGSHME SIKA PËR TARRACAT/ÇATITË

Sistemet e membranave të lëngshme Sika bëjnë të mundur materializimin e projekteve dhe koncepteve arkitekturore jo të zakonshme. Sistemet aplikohen si në veprat e reja, por edhe në rikonstrukcione kur përdorimi i membranave sintetike është procedurë e ndërlikuar dhe nuk garantohej aplikimi i shpejtë, efikas dhe i sigurt.

Sika disponon një histori gati gjysëm shekullore në teknologjinë e membranave të lëngshme dhe hidroizolimit të tarracave/ çatitë. Gjatë viteve 1960 Sika hodhi themelet e zhvillimit të kësaj teknologjie dhe sot është lider në botë në një treg që zhvillohet fuqishëm.

Sika nuk ofron vetëm një gamë të gjerë teknologjish dhe sistemesh, por gjithashtu dhe shërbime të plota teknike që të sigurohet përfundimi i suksesshëm i çdo projekti të veçantë. Që në fazën e ofrimit të konsulentëve dhe standardit, deri në ofrimin e shërbimit teknik dhe vlerësimin e cilësisë së aplikimit përfundimtar, Sika është bashkëpunëtori i besueshëm për të gjithë studiuesit, arkitektët, inxhinierët, aplikuesit, pronarët privatë.

KARAKTERISTIKA

AVANTAZHE

PËRFITIME

<ul style="list-style-type: none"> ■ Aplikim me metodën e lëngët 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Adaptim i lehtë në detaje të ndërlikuara ■ Zgjedhje ideale për rinovimin e tarracave ekzistuese ■ Pa shpim të konstruksionit ekzistues të tarracës/ çatisë 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Aplikim i shpejtë, i lehtë dhe i sigurt ■ Zgjatje e afatit të shërbimit të tarracave të vjetra ose tarracave që kanë dështuar, pa ndërprerjen e funksionimit të konstruksionit ■ Rrezik më i ulët dështimi të hidroizolimit të tarracës/ çatisë
<ul style="list-style-type: none"> ■ Shumë lloje dhe teknologji 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Të përshtatshme për lloje të ndryshme tarracash/çatish dhe nënshtresash ■ Ideale për punime rikonstrukcioni 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Shumëllojshmëri aplikimesh ■ Zgjatje e ciklit të jetës së tarracave të vjetra apo tarracave që kanë dështuar, pa ndërprerje të përdorimit të konstruksionit
<ul style="list-style-type: none"> ■ Elasticitet i lartë ■ Ruan elasticitetin dhe në temperatura të ulëta 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Aftësi e mirë për mbyllje plasaritjesh edhe në temperatura të ulëta 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Rrezik më i ulët dështimi të hidroizolimit të tarracës/çatisë edhe në klimë të ftohtë
<ul style="list-style-type: none"> ■ Pa tegela dhe bashkime 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Pa tegela apo bashkime 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Rrezik më i ulët dështimi të hidroizolimit të tarracës/ çatisë
<ul style="list-style-type: none"> ■ Aplikim i ftohtë (pa përdorim flake) 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Pakësim i rrezikut të aksidenteve (zjarr) 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Siguri
<ul style="list-style-type: none"> ■ Ndërkapje e plotë mbi nënshtresë 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Pa depërtim uji midis nënshtresës dhe membranës në rast gabimi në aplikim ose dëmtim të membranës së lëngshme 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Lokalizim më i lehtë i dështimeve në rast hyrjeje uji ■ Rrezik i kufizuar i dështimit të hidroizolimit
<ul style="list-style-type: none"> ■ Rezistencë e lartë ndaj rrezatimit UV 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Hidroizolim rezistent për tarracat e ekspozuara 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Rrezik më i ulët dështimi të hidroizolimit të tarracës/ çatisë ■ Afat më i madh i jetëgjatësisë së shtresës hidroizoluese
<ul style="list-style-type: none"> ■ Përshkueshmëri avujsh uji 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Lejon transpirimin e nënshtresës 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Lagështia e bllokuar mund të largohet pa krijuar fluska tek shtresa
<ul style="list-style-type: none"> ■ Shumëllojshmëri ngjyrash 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Liri projektimi 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Zgjerim i aplikimeve të mundshme
<ul style="list-style-type: none"> ■ Koeficient i lartë reflektiviteti të rrezatimit diellor kur aplikohet në ngjyrë të bardhë 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Ideale për tarracat e ftohta dhe tarraca me panele fotovoltaike 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Përmirësim i efikasitetit energjetik

APLIKIMI I SISTEMEVE TË MEMBRANAVE TË LËNGSHME SIKA

TË KATEGORIZUARA SIPAS LLOJIT, TARRACAT/ ÇATITË në një konstruksion mund të jenë të ekspozuara dhe të aksesueshme deri në të gjelbra (me mbjellje) ose të funksionojnë deri në katin e fundit në një ndërtesë shumëkatëshe për parkimin e automjeteve. Përdorimet e ndryshme kërkojnë sisteme dhe njohuri teknike të posaçme. Sika është një nga prodhuesit më të mëdhenj të sistemeve të membranave të lëngshme në të gjithë botën, duke disponuar një shumëllojshmëri të gjerë teknologjish, të përshtatshme për pothuajse të gjitha llojet.

LLOJET E TARRACAVE/ ÇATITË KU MUND TË APLIKOHEN SISTEMET E MEMBRANAVE TË LËNGSHME

TARRACA TË EKSPOZUARA



- Tarraca të sheshta
- Tarraca të pjerrëta
- Tarraca të ftohta

TARRACA TË PËRDORSHME



- Tarraca
- Vende parkimi automjeteve

TARRACA TË GJELBRA



- Tarraca të gjelbra të llojit intensiv
- Tarraca të gjelbra të llojit ekstensiv

TARRACA TË FTOHTA & TARRACA ME PANELE DIEJLORE




- Tarraca për efikasitet energjetik

TARRACA ME BALAST



- Tarraca të ngrohta
- Tarraca inverse

TARRACA/ ÇATI NË NDËRTESA ME RËNDËSI HISTORIKE



Sistemet e membranave të lëngshme Sika mund të aplikohen pothuajse në të gjitha llojet e tarracave/ çatitë dhe janë veçanërisht të përshtatshme për tarraca/ çati me gjeometri dhe detaje të ndërlikuara. Përveç kësaj, si sisteme pa tegela dhe bashkime janë përzgjedhja e duhur për tarracat/ çatitë me kërkesa estetike të larta dhe performancë afatgjatë.

APLIKIMI I SISTEMEVE TË MEMBRANAVE TË LËNGSHME SIKA

RESTAURIMI I TARRACAVE/ ÇATIVE ekzistuese ka marrë në ditet e sotme rëndësi të madhe si një mjet i qëndrueshëm për zgjatjen e afatit të përdorimit të tarracës/ çatisë, por edhe të të gjithë konstruksionit. Ndërsa konstruksionet e ndërtesave projektohen zakonisht për jetëgjatësi prej 50 vitesh, tarraca/ çatia e konstruksionit mund të ketë nevojë për mirëmbajtje ose riparim në faza të ndryshme që të sigurohet mbrojtja e mjaftueshme ndaj depërtimit të ujit ose substancave të tjera dëmtoese të atmosferës. Membranat e lëngshme Sika mund të përdoren mbi një gamë të gjerë tarracash/ çatisë ekzistuese, si një zgjidhje efikase & ekonomike për punimet riparuese dhe rinovuese.

Një nga avantazhet më të mëdha të sistemeve të membranave të lëngshme është fakti se shtresa ekzistuese e hidroizolimit nuk është e nevojshme të hiqet. Membranat e lëngshme Sika aplikohen në kombinim me prajmerin e duhur direkt mbi sipërfaqen e tarracës/ çatisë. Procedura e aplikimit krijon

bezdi minimale në funksionalitetin e përditshëm të ndërtesës. Gjithashtu, aplikimi i tyre bëhet me metodën e ftohtë, pa zjarr siç kërkohet gjatë aplikimit të membranave bituminoze. Kjo gjë sjell siguri, si për vetë konstruksionin, por edhe për aplikuesin. Sidomos për sa i përket riparimit të shtresës ekzistuese

së hidroizolimit të tarracës/ çatisë në ndërtesa publike, shkolla, spitale, kopështe/çerdhe, zyra, etj., membranat e lëngshme janë zgjidhja e duhur me kriter kryesor sigurinë e njerëzve që gjenden brenda ndërtesës.



Në raste të caktuara sistemet e membranave të lëngshme, jo vetën zgjasin afatin e funksionimit të tarracave/ çative ekzistuese, por ofrojnë gjithashtu mundësi zgjerimi të funksionalitetit, por edhe përmirësimin të estetikës së një tarrace/ çatie.



Kur aplikohen në ngjyrë të bardhë (RAL 9016), sistemet e membranave të lëngshme ofrojnë veti të shkëlqyera koeficienti reflektiviteti të rrezatimit diellor, duke i bërë automatikisht këto tarraca si të "fthohta" (Cool Roofs). Në këtë mënyrë kufizohet fenomeni i ishullit urban, por edhe kostoja totale energjetike që kërkohet për ftohjen e ndërtesës.

NËNSHTRESA APLIKIMI

BETON



METALE



BITUM



TULLA DHE GURË



MBULESA ETERNITI



MEMBRANA SINTETIKE



DRU



TJEGULLA



BAKËR



VESHJE TË VJETRA



KARAKTERISTIKA KRYESORE E MEMBRANAVE TË LËNGSHME: FLEKSIBILITETI I TYRE!

PERFORMANCA TEKNOLOGJIKE E SISTEMEVE TË MEMBRANAVE TË LËNGSHME

SIKA - LIDER NË TEKNOLOGJINË E SISTEMEVE TË MEMBRANAVE TË LËNGSHME



Që nga viti 1910, Sika njihet gjerësisht për ofrimin e zgjidhjeve të cilësisë së lartë për hidroizolimim dhe ndërtesave dhe sot është prodhuesi kryesor i membranave të lëngshme të të gjitha bazave kimike:

- Poliuretan
- Akrilik
- Poliure
- Hibrid

Katër qendra pefirerike teknologjike zhvillojnë receta dhe kombinime të reja me lëndët e para vendase që disponohen, duke siguruar ofrimin e produkteve me cilësi të lartë, të përshtatshme për aplikim në kushtet klimaterike lokale dhe sipas standardeve në fuqi. Rrjeti ndërkombëtar i shkencëtarëve dhe studiuesve tanë bazohet tek një përvojë gjysëm shekullore në zhvillimin e sistemeve të membranave të lëngshme. Si një lider në ofrimin e sistemeve hidroilimi të tarracave, Sika synon përmirësimin e vazhdueshëm të teknologjive ekzistuese duke patur si kritere bazë zhvillimin e qëndrueshëm, shëndetin, sigurinë dhe gjithnjë cilësinë në ofrimin e zgjidhjeve.

INCOREZ - PJESË E GRUPIT SIKA



Ngjarje e rëndësishme në ruajtjen e pozicionit lider të Sika-s ishte blerja e kompanisë Incorez në 2008.

Incorez është lider në botë të kiminë e oksazolidinës, duke prodhuar një gamë të gjerë produktesh. Seria e aditivëve të posaçëm të Incozol® u përdor gjerësisht tek produktet e hidroizolimimit me bazë poliuretani, me 1 dhe 2 përbërës. Këto aditivë funksionojnë si binder (substancë lidhëse) lagështie, tretës reaktivë dhe agjentë latentë maturimi.

Përveç këtyre, kompania disponon përvojë të madhe në teknologjinë me rrezikshmëri të ulët dhe me bazë uji, duke prodhuar një gamë të gjerë poliuretanësh alifatikë me bazë uji dhe një shumëllojshmëri agjentësh maturimi epoksidësh të tretëshme në ujë. Materialet përdoren gjerësisht për prodhimin e shtresave me performancë të lartë për shumë lloje aplikimesh. Njësie e prodhimit ndodhet në Preston të Anglisë, ku i gjithë prodhimi realizohet sipas standardit ISO 9001 për sigurimin e cilësisë. Kompania është certifikuar sipas standardeve BS OHSAS 18001 dhe ISO 14001 që tregojnë angazhimin e vazhdueshëm të kompanisë në çështjet e shëndetit, sigurisë dhe menaxhimit të mjedisit.

Incorez
custom chemistry

MJEDISËT E STUDIMIT, ZHVILLIMIT & PRODHIMIT



Përparësi për Sika-n mbetet gjithnjë përmbushja e kërkesave të klientit, duke u përqëndruar në studimin e veçantive të metodave vendase të prodhimit. Një nga shtyllat kryesore të strategjisë së Sika-s është prodhimi vendas i produkteve për ndërtimin që janë zhvilluar nga një rrjet i konsoliduar i qendrave ndërkombëtare, periferike dhe vendore të qendrave teknologjike Sika.



Më shumë se 20 fabrika vendase prodhimi sistemesh dhe produkteve membranash të lëngshme, në periferi të ndryshme në botë, sigurojnë dorezimin e produkteve në çdo vepër.

Qendrat tona teknologjike dhe mjediset e prodhimit janë të shpërndara në të gjithë botën. Për shkak të kushteve të ndryshme të mjedisit, kërkesat për performancë dhe standardet në fuqi të membranave për tarracat ndryshojnë nga njëri rajon në tjetrin. Produktet dhe sistemet tona janë krijuar për të përmbushur standardet vendase, me synim ofrimin e zgjidhjeve ekonomike dhe rezistente, për çdo kërkesë.

BASHKËPUNIM GLOBAL, POR EDHE VENDOR



TARRACA/ ÇATI TË FTOHTA ME MEMBRANA TË LËNGSHME HIDROIZOLIMI

TARRACAT/ ÇATITË E FTOHTA U LEJOJNË PRONARËVE, arkitektëve, inxhinierëve dhe konsulentëve të përmirësojnë performancën energjetike dhe mjedisore të një ndërtese dhe kontribuojnë në reduktimin e ndjeshëm të fenomenit të "ishullit termik urban" në qytetet e mëdha.

PËRSE TARRACA/ ÇATI TË FTOHTA?


Tarracat/ çatitë e ftohta minimizojnë përthithjen e nxehtësisë së rrezatimit diellor dhe si pasojë i mbajnë më të ftohta sipërfaqet e tarracave. Materialet që përdoren për këtë aplikim reflektojnë rrezatimin diellor (tregues i lartë reflektiviteti diellor), duke çliruar njëkohësisht nxehtësinë e përthithur (emision i rrezeve infra të kuqe).



Temperatura e tarracës/ çatisë përpara aplikimit të membranës së lëngshme




Temperatura e tarracës/ çatisë pas aplikimit të membranës së lëngshme



AVANTAZHET

- Konsumim energjetik më i ulët për ftohjen e vendit
- Reduktim i fenomenit të "ishullit termik urban"
- Reduktim i sforcimit termik të tarracës dhe materialit të hidroizolimit të lëngshëm
- Reduktim i kostove për mirëmbajtje dhe riparime
- Ndikim pozitiv në mjedis, në nivel botëror
- Performancë e përmirësuar e paneleve fotovoltaike
- Pajtuueshmëri me LEED v2009 (SSc 7.2) / v4 (SSc 5)



Çati e ftohtë në një fabrikë ndërtimi avionësh, Cadiz, Spanjë

KONTRIBUTI I SIKALASTIC PËR TARRACAT/ ÇATITË E FTOHTA

Sika është njëri nga anëtarët e parë dhe aktivë të Këshillit të Vlerësimit për Tarracat/ Çatitë e Ftohta (CRRC Cool Roof Rating Council), që u themelua në vitin 1998 në SHBA, si edhe Këshillit Europian për Tarracat/ Çatitë e Ftohta (ECRC European Cool Roofs Council).

Sistemet Sikalastic® kontrollohen menjëherë pas aplikimit të tyre dhe pas 3 vitesh nën ndikimet e motit për sa i përket reflektivitetit diellor dhe çlirimit termik dhe listohen në katalogun e CRRC - Indeksi i produkteve të renditura.



TARRACA/ ÇATI TË FTOHTA ME MEMBRANA TË LËNGSHME

Membranat e lëngshme Sikalastic®, të aplikuara në ngjyrën Traffic White (RAL 9016) kanë reflektivitet të lartë diellor dhe absorbueshmëri të ulët termike, gjë që tregon indeks të lartë reflektiviteti diellor (SRI Solar Reflectance Index), indeksi kryesor i reflektivitetit të një sipërfaqeje. Sa më i lartë indeksi SRI, aq më i lartë reflektiviteti i tarracës dhe aq më e "ftohtë" tarraca/ çatia.

Produkti Sika	Reflektiviteti diellor	Çlirimi termik	Indeksi i reflektivitetit diellor (SRI)
	Fillestar	Fillestar	Fillestar
Sika® SolaRoof® MTC-15	0,85	0,9	107
Sikalastic®-570 TC e bardhë	0,86	0,89	108
Sikalastic®-560 e bardhë	0,84	0,9	106
Sikagard® -570 W Pele Elastica® + Fibras	0,81	0,84	104
Sikafill® e bardhë	0,80	0,88	100

TEKNOLOGJI & PRODUKTE

MEMBRANA TË LËNGSHME HIDROIZOLIMI ME BAZË UJI

MEMBRANAT E LËNGSHME ME BAZË UJI për hidroizolim përbëjnë njërin nga teknologjitë e para të membranave të lëngshme për tarracat/ çatitë dhe zënë akoma një pjesë të madhe të tregut. Falë karakteristikave të tyre, në të cilat përfshihet rrezikshmëria e ulët, qëndrueshmëria e shkëlqyer, rezistenca ndaj rrezatimit UV dhe lehtësia në aplikim, emulsionet akrilike dhe tretësirat e modifikuara prej poliuretani janë tepër të njohura, sidomos në zonat me klimë të butë.



Kompleks banesash, Kuala Lumpur, Malajzi

KARAKTERISTIKA

AVANTAZHE

PËRFITIME

■ Pa tretës	■ Pothuajse pa erë ■ Klasë e ulët rrezikshmërie	■ Aplikim pa ndërprerje të punimeve të tjera ■ Rrezik i ulët për shëndetin, siguri e lartë për përdoruesin
■ Rezistencë ndaj rrezatimit UV & zverdhjes	■ Kontribuojnë në ruajtjen e indeksit të lartë të reflektivitetit diellor (SRI)	■ Performancë energjetike e qëndrueshme
■ 1 përbërës	■ Përdorim i lehtë, gati për aplikim	■ Kohë e shkurtër aplikimi ■ Pa rrezik për gabime gjatë përzierjes
■ Teknologji e thjeshtë	■ Ekonomik	■ Kursim i kostos
■ Ambalazhe në enë me përmasa të ndryshme	■ Lehtësi në transport ■ Lehtësi në përdorim	■ Fleksibiliteti gjatë aplikimit ■ Kursim i kostos gjatë përdorimit në kantier

MEMBRANA TË LËNGSHME, TEKNOLOGJIA CET (CO-ELASTIC TECHNOLOGY)

Teknologjia **CO ELASTIC TECHNOLOGY (CET)** e Sika-s përkrah membranat e lëngshme të modifikuara akrilike, të cilat kombinojnë performancën e lartë të poliuretanit dhe tretësirave të tjera me vetitë e njohura të akrilikëve. Si rezultat, membranat e lëngshme të kësaj teknologjie, paraqesin konsumim shumë të ulët të ujit dhe veti mekanike të larta në krahasim me membranat konvencionale akrilike, duke i bërë më rezistente dhe më afatgjata. Teknologjia Co-Elastic e Sika-s përmban materiale pa tretës dhe pa erë, duke bërë kështu të mundshëm aplikimin e tyre në rastet ku kërkohen materiale pa erë dhe rrezikshmëri të ulët. Gjithashtu, këto membra disponojnë qëndrueshmëri të shkëlqyer ndaj rrezatimit UV dhe indeks të lartë reflektiviteti diellor (SRI) të aplikuara në ngjyrë të bardhë (RAL 9016), duke çuar kështu në pajtueshmëri me standardin LEED v2009 (SSc 7.2)/v4 (SSc 5).



Ndërtesë qeveritare, Buenos Ajres, Argjentinë

TEKNOLOGJI & PRODUKTE

MEMBRANA TË LËNGSHME, ME 1 PËRBËRËS, POLIURETANI PËR HIDROIZOLIMIN E TARRACAV/ ÇATIVE

MEMBRANAT E LËNGSHME POLIURETANI me 1 përbërës për hidroizolim të tarracave/çative u zhvilluan gjatë dekadës së 1960 dhe përfaqësojnë një teknologji të nevojshme për sektorin e hidroizolimit të tarracave/ çative në ditët tona. Falë karakteristikave të larta dhe fleksibilitetit të tyre, veçanërisht në temperatura të ulëta, ashtu si dhe falë aftësisë së tyre për t' u maturuar në shumëllojshmëri kushtesh moti, membranat e lëngshme prej poliuretani janë të përshtatshme për përdorim në kushte kërkuese klimaterike.



Sallë konferencash, Gjermani

KARAKTERISTIKA


- Tharje e shpejtë
- Rezistencë ndaj rrezatimit UV & zverdhjes (shtresa përfundimtare alifatike)
- 1 përbërës
- Ambalazhe në formë kove

AVANTAZHE

- Rezistencë ndaj shiut pothuajse direkt pas aplikimit
- Kohë e shkurtër priteje nga shtresa në shtresë
- Ruan indeksin e lartë të reflektivitetit diellor (SRI)
- Aplikim i lehtë, gati për përdorim
- Transport i lehtë
- Përdorim i lehtë

PËRFITIME

- Fleksibilitet i lartë gjatë aplikimit të kushte të paqëndrueshme moti
- Kursim kohe
- Efikasitet i qëndrueshëm energjetik
- Kursim i kohës së aplikimit
- Pa rrezik gabimesh gjatë përzjerjes
- Fleksibilitet në aplikim
- Kursim i kostos gjatë përdorimit në kantier



TEKNOLOGJIA MTC (MOISTURE TRIGGERED TECHNOLOGY)

Sistemet e Sika-s me bazë teknologjinë MTC, përfshijnë membrana të lëngshme me bazë një lloj teknologjie unike maturimi që aktivizohet me lagështinë, por nuk ndikohet prej saj gjatë maturimit. Kjo do të thotë se këto membrana mund të maturohen në kushte shumë të ndryshme, duke përfshirë luhatjet ekstreme të temperaturës dhe lagështisë. Ndryshe nga sistemet konvencionale prej poliuretani të membranave të lëngshme, këto nuk çlirojnë CO₂, diçka që shkakton shpesh fenomene shkumëzimi dhe aplikimi i tyre nuk ndikohet nga kushtet e pafavorshme të mjedisit.



SISTEME MEMBRANASH TË LËNGSHME Sika®

SISTEM KËRKESASH KONVENCIONALE

Sikafill®

Membranë e lëngshme elastike me 1 përbërës, prej akriliku

PËRDORIMET

- Hidroizolim tarracash të reja dhe të vjetra
- Membranë reflektive (SR=0,80)
- Hidroizolim tarracash me akses të kufizuar
- Hidroizolim tarracash me shumë detaje dhe formë të ndërlikuar

KARAKTERISTIKAT

- Elasticitet i lartë
- Mundësi për mbylljen e mikro-plasaritjeve
- Qëndrueshmëri e lartë ngjyre / nuk zverdhet
- Disponohet në 3 ngjyra (e bardhë, gri, terracotta)
- Aplikim i lehtë
- Ndërkapje e mirë mbi nënshtresa të ndryshme
- Aplikohet edhe mbi sipërfaqe vertikale
- Nuk ka rezistencë ndaj ujërave të ndenjtur mbi sipërfaqe
- Sipas ETAG 005-8 (W2, P3)
- Ekonomik
- Aplikim me rul me fije të shkurtëra ose spërkatje

AMBALAZHI

Kovë 1kg, 5kg, 12kg, 20kg



STRUKTURA E SISTEMEVE

Sistem i papërfortuar për aplikim në tarraca & sipërfaqe vertikale	Sistem i përfortuar për aplikim në tarraca me kërkesë për rezistencë të shtuara	Sistem i përfortuar për aplikim në tarraca me kërkesë për qarkullim të kufizuar
Prajmer*	Prajmer*	Prajmer*
Shtresa bazë: 2 x Sikafill®	Shtresa e parë: 1 x Sikafill®	Shtresa e parë: 1 x Sikafill®
	Përfortimi: Sikalastic® Fleece-120	Përfortimi: Sikalastic® Fleece-120
	Shtresa e fundit: 1 x Sikafill®	Shtresa e dytë: 1 x Sikafill®
		Shtresa e fundit/boja mbrojtëse: 1 x Sikagard®-550 W Elastic

Prajmerat e sugjeruar për sistemet e membranave të lëngshme Sikafill®

Sikafill® (i holluar)	Hollimi i materialit bëhet me 25% ujë
SikaColor®-500 W Primer	
Sikagard®-552 W Aquaprimer	

SISTEM PËR KËRKESA TË LARTA

Sikagard® -570 W Pele Elástica® + Fibras

Membranë e lëngshme elastike me 1 përbërës prej akriliku dhe e përfortuar me fibra

PËRDORIMET

- Hidroizolim tarracash të reja dhe të vjetra
- Hidroizolim tarracash me akses dhe qarkullim të kufizuar
- Hidroizolim sipërfaqesh vertikale

KARAKTERISTIKAT

- Elasticitet i lartë
- Mundësi e lartë për mbylljen e mikro-plasaritjeve
- Përkrahshmëri e mirë nga avujt e ujit
- Rezistencë e lartë ndaj depërtimit të CO₂
- Disponohet në 3 ngjyra (e bardhë, gri, ngjyrë tulle)
- Aplikim në trashësi të madhe
- Ndërkapje e mirë mbi nënshtresa të ndryshme
- Aplikohet edhe mbi sipërfaqe vertikale
- Rezistencë ndaj sforcimeve nga mjedisi
- Nuk ka rezistencë ndaj ujërave të ndenjtur mbi sipërfaqe
- Sipas EN 1504-2
- Aplikim me rul me fije të shkurtëra ose spërkatje

AMBALAZHI

Kovë 18kg



STRUKTURA E SISTEMIT

Nënshtresa minerale / bituminoze / metalike
Prajmer*
2-3 x Sikagard® -570 W Pele Elástica® + Fibras

Prajmerat e sugjeruar për sistemin Sikagard®-570 W Pele Elástica+Fibras sipas llojit të nënshtresës

Prajmer	Lloji i nënshtresës		
	Me bazë çimentoje	Bituminoze	Metalike
Sikagard® -570 W Pele Elástica® + Fibras (i holluar me 10% ujë)	▲	▲	
Sikagard®-552 W Aquaprimer	▲		
Sika® Color-500 W Primer	▲		
SikaCor® EG-1			▲

SISTEME MEMBRANASH TË LËNGSHME Sika®

SISTEM ME PERFORMANCË TË LARTË

Sikalastic®-560

Membranë e lëngshme elastike me 1 përbërës prej akriliku, e modifikuar me poliuretan (hibrid), me bazë teknologjinë CO-Elastic (CET)

PËRDORIMET

- Hidroizolim tarracash të reja dhe të vjetra
- Membranë reflektive (SR=0,82)
- Hidroizolim tarracash me akses të kufizuar
- Hidroizolim tarracash me numër të madh detajesh dhe formë të ndërlikuar
- Zgjatje me kosto efikase të ciklit të jetës të sistemeve që kanë dështuar
- Hidroizolim poshtë pllakave, në veranda dhe ballkone

KARAKTERISTIKAT

- Elasticitet i lartë
- Mundësi përmblylljen e mikro-plasaritjeve
- Qëndrueshmëri e lartë ngjyre / nuk zverdhet
- Disponohet në ngjyrë të bardhë (gri, terracotta, e kuqe vetëm me porosi)
- Përshkueshmëri e mirë nga avujt e ujit
- Rezistencë e lartë ndaj depërtimit të CO₂
- Ndërkapje e shkëlqyer mbi nënshtresa poroze dhe joporoze
- Aplikohet edhe mbi sipërfaqe vertikale
- Ndikim i reduktuar nga prania e ujërave të grumbulluar
- Rezistencë ndaj zjarrit, sipas EN 1187 Broof (T1)
- Sipas ETAG 005-8 (W3, P1)
- Plotëson kërkesat e LEED EQ Credit 4.2, SS Credit 7.2
- Ekonomik
- Aplikim me rul me fije të shkurtëra ose me spërkatje



AMBALAZHI

Kovë 20kg

STRUKTURA E SISTEMEVE

Sistem pa përforcim për aplikim mbi beton, metal, dru, pllaka	Sisteme me përforcim për aplikim mbi beton, metale, dru, pllaka, membrana bituminoze	
Prajmer*	Prajmer*	Prajmer*
Shtresa bazë: 2-3 x Sikalastic®-560	Shtresa bazë: 2 x Sikalastic®-560	Shtresa bazë: 2 x Sikalastic®-560
	Përforcimi: Sikalastic® Fleece-120	Përforcimi: Sika® Reemat Premium
	Shtresa përfundimtare: 1 x Sikalastic®-560	Shtresa përfundimtare: 2 x Sikalastic®-560

Prajmerat e sugjeruar sipas llojit të nënshtresës			
Prajmeri	Nënshtresë me bazë çimentoje	Nënshtresë bituminoze	Nënshtresë metalike
Sikalastic®-560 (i holluar me 10% ujë)	▲		
Sikalastic® Metal Primer		▲	▲

SISTEM ME PERFORMANCË TË SHKËLQYER

Sikalastic®-612

Membranë e lëngshme elastike me 1 përbërës prej poliuretani, e teknologjisë MTC



PËRDORIMET

- Hidroizolim tarracash të reja dhe të vjetra
- Hidroizolim tarracash me akses të kufizuar
- Membranë hidroizolimi rezistente pa tegela dhe bashkime
- Hidroizolim poshtë pllakave, në veranda dhe ballkone
- Hidroizolim tarracash me shumë detaje dhe formë të ndërlikuar

AMBALAZHI

Kovë 1kg, 7,1kg, 21,3kg (0,75L, 5L, 15L)

KARAKTERISTIKAT

- Rezistencë ndaj shiut, pothuajse menjëherë pas aplikimit (teknologjia MTC)
- Elasticitet i lartë
- Mundësi mbylljeje të plasaritjeve
- Rezistencë e lartë
- Disponohet në 3 ngjyra (e bardhë, gri, terracotta)
- Përshkueshmëri e mirë e avujve të ujit
- Ndërkapje e shkëlqyer mbi shumicën e nënshtresave
- Aplikohet edhe mbi sipërfaqe të pjerrëta / vertikale
- Rezistencë ndaj ujërave të grumbulluar
- Rezistencë ndaj zjarrit, sipas EN 1187 Broof (T1)
- Sipas ETAG 005-6 (W2, P4)
- Aplikim me rul me fije të shkurtëra ose me spërkatje

STRUKTURA E SISTEMIT

Pa përforcim	Me përforcim	Hidroizolim poshtë pllakave të ngjitura me kollë	Sistem i përforcuar ku aplikohet shtresë mbrojtëse përfundimtare
Prajmer*	Prajmer*	Prajmer*	Prajmer*
1-2 x Sikalastic®-612	Shtresa bazë: 1-2 x Sikalastic®-612	Shtresa bazë: 1-2 x Sikalastic®-612	1 x Sikalastic®-612
	Përforcimi: Sikalastic® Fleece-120 ose Sika® Reemat Premium	Shtresa e fundit: 1-2 x Sikalastic®-612	Sikalastic® Fleece-120 / Sika® Reemat Premium
	Shtresa përfundimtare: 1-2 x Sikalastic®-612	Urë ndërkapjeje: Sikalastic®-612 me spërkatje rëre kuarci (ø 0,4 - 0,7mm) konsumimi 2 kg /m ²	1 x Sikalastic®-612
		Shtresa përfundimtare: Shtrim pllakash me kollën me bazë çimentoje SikaCeram®	1 x Sikalastic®-570 TC / Sikalastic®-621 TC


Prajmeri	Prajmerat e sugjeruar sipas llojit të nënshtresës			
	Lloji i nënshtresës			
	Çimentoje	Bituminoze	Metalike	Veshje ekzistuese poliuretani
Sikalastic® Concrete Primer	▲			
Sikalastic® Metal Primer		▲	▲	
Sikalastic® Bonding Primer	▲			
SikaCor® EG-1			▲	
Sikafloor®-161	▲			
Sika® Reactivation Primer				▲

SISTEME MEMBRANASH TË LËNGSHME Sika®

SISTEMET SIKALASTIC® MTC

Sikalastic® MTC

Sistem poliuretani të lëngshëm për hidroizolim të tarracave/ çatave që aplikohet me metodën e ftohtë, pa fuga, me elasticitet të lartë dhe rezistencë ndaj rrezatimit UV, i cili bazohet në teknologjinë e maturimit që aktivizohet me lagështinë, por nuk ndikohet prej saj (MTC). Përbëhet nga produktet Sikalastic®-601 BC, Sika® Reemat Premium dhe Sikalastic®-621 TC.



PËRDORIMET

- Hidroizolim tarracash/ çatish në konstruksione të reja dhe rikonstruksione.
- Për tarraca/ çati me forma dhe detaje të ndërlikuara, edhe kur aksesimi është i kufizuar.
- Për zgjatje me kosto efektive të ciklit të jetës së sistemeve për tarracat/ çatitë që kanë dështuar.
- Kombinohet me Sikalastic®-621 TC - SR (traffic white RAL 9016) për tarrace të ftohta dhe diellore.

KARAKTERISTIKAT / AVANTAZHET

- Teknologji e provuar - historik aplikimesh mbi 25 vjet
- 1 përbërës - pa përzjerje, gati për përdorim dhe aplikim i lehtë
- Rezistencë ndaj rrezatimit UV - Reflektivitet i lartë (RAL9016) dhe rezistencë ndaj zverdhjes
- Aplikim me metodën e ftohtë - nuk kërkohet nxehtësi ose zjarr
- Membranë hidroizolimi tarracash/ çatish pa fuga
- Tharje e shpejtë - asnjë dëmtim i membranës pothuajse menjëherë pas aplikimit
- Elasticitet i lartë dhe me mundësi mbylljeje të plasaritjeve - ruan fleksibilitetin e tij edhe në temperatura të ulëta
- Rezistencë e lartë ndaj depërtimit të rrënjëve
- Mund të rivishet me lehtësi nëse kërkohet - nuk kërkohet largimi i tij
- Ndërkapje e mirë mbi shumicën e nënshtresave - lexo tabelën e prajmerave
- I përshkueshëm nga avujt e ujit - lejon transpirimin e nënshtresës
- Rezistencë e lartë nga kimikateve të zakonshme të atmosferës


STRUKTURA E SISTEMIT

Prajmer*				
Shtresa bazë: Sikalastic®-601 BC				
Përforcimi: Sika® Reemat Premium				
Shtresa përfundimtare: Sikalastic®-621 TC				
Prajmerat e sugjeruar sipas llojit të nënshtresës				
Prajmeri	Lloji i nënshtresës			
	Me bazë çimentoje	Bituminoze	Metalike	Veshje ekzistuese poliuretani
Sikalastic® Concrete Primer	▲			
Sikalastic® Metal Primer		▲	▲	
Sikalastic® Bonding Primer	▲			
Sika® Reactivation Primer				▲



SISTEME PËR TARRACAT/ ÇATITË E EKSPOZUARA

SISTEME PA TERMOIZOLIM



KËRKESAT

- Hidroizolim pa tegela dhe bashkime
- Me pak erë
- Pa tretës
- Pa shpime tek nënshtresa


ZGJIDHJA NGA SIKA

Tarraca/ çati të ftohta duke përdorur sistemet Sikalastic®-560

SISTEMET SIKA

Sistem me Sikalastic®-560

- 1-3 shtresa përfundimtare Sikalastic®-560
- Përforcim me rrjetën Sika® Reemat Premium ose Sikalastic® Fleece-120
- Shtresa bazë Sikalastic®-560
- Prajmeri Sikalastic®-560 i holluar me 10% ujë
- Nënshtresë betoni



KËRKESAT

- Hidroizolim pa tegela dhe bashkime
- Tharje e shpejtë
- Pa shpime tek nënshtresa
- Rezistencë e shtuar ndaj zjarrit
- Reflektivitet i lartë (me përdorimin e Top Coat)


ZGJIDHJA NGA SIKA

Tarraca/ çati të ftohta duke përdorur sistemet Sikalastic®-612

SISTEMET SIKA

Sistem me Sikalastic®-612

- 1-2 shtresa Sikalastic®-570 ose 1 shtresë Sikalastic®-621 TC
- Përforcim me rrjetën Sika® Reemat Premium ose Sikalastic® Fleece-120
- Prajmeri Sika® Bonding Primer ose Sika® Concrete Primer
- Nënshtresë betoni



KËRKESAT

- Hidroizolim pa tegela dhe bashkime
- Tharje e shpejtë
- Pa shpime tek nënshtresa
- Rezistencë e shtuar ndaj zjarrit
- Mundësi dhënieje garancie të shkruar me afat deri në 20 vjet

ZGJIDHJA NGA SIKA

Tarraca/ çati të ftohta duke përdorur sistemet SikaRoof® MTC



SISTEMET SIKA

SikaRoof® MTC 12/15/18/22

- 1-2 shtresa Sikalastic®-621 TC
- Përforcim me rrjetën Sika® Reemat Premium
- Shtresa bazë Sikalastic®-601 BC
- Prajmeri Sika® Concrete Primer
- Nënshtresë betoni



SISTEME PËR TARRACAT/ ÇATITË E GJELBRA



KËRKESAT

- Tarraca/ çati të gjelbra të llojit ekstensiv
- Aplikim i shpejtë me pajisje mekanike
- Kosto e ulët mirëmbajtjeje
- Hidroizolim tarrace/ çatiye pa fuga dhe bashkime
- Pa depërtim uji poshtë membranës

ZGJIDHJA NGA SIKA

Tarracë/ çati inverte me membranë të lëngshme poliuretani

SISTEMI SIKA

- Zhvillim tarrace/ çatie të gjelbër (lloji ekstensiv)
- Termoizolim XPS
- Sistemi Sikalastic® MTC-22
- Prajmer Sikafloor®-156/-161 (ose tjetër, sipas kërkesës)
- Nënshtrësë betoni

KËRKESAT

- Tarraca/ çati të gjelbra të llojit intensiv
- Aplikim i shpejtë me pajisje mekanike
- Hidroizolim tarrace/ çatie pa fuga dhe bashkime
- Pa depërtim uji poshtë membranës

ZGJIDHJA NGA SIKA

Tarracë/ çati inverte me membranë të lëngshme poliuretani


SISTEMI SIKA

- Zhvillim tarrace/ çatie të gjelbër (lloji intensiv)
- Termoizolim XPS
- Sistemi Sikalastic® MTC-22
- Prajmer Sikafloor®-156/-161 (ose tjetër, sipas kërkesës)
- Nënshtrësë betoni



SISTEME PËR RESTAURIMIN E TARRACAVE/ÇATIVE EKZISTUESE

TARRACA/ ÇATI METALIKE EKZISTUESE




KËRKESAT

- Aplikimi shpejtë dhe i lehtë (aplikim direkt mbi tarracën/çatinë metalike, pa shtresë niveluese)
- Hidroizolim pa tegela dhe bashkime
- Pa shpime mbi nënshtresën metalike
- Pa tretës

ZGJIDHJA NGA SIKA

Hidroizolim tarrace/ çatie metalike me Sikalastic®-560




KËRKESAT

- Aplikimi shpejtë dhe i lehtë (aplikim direkt mbi tarracën/çatinë metalike, pa shtresë niveluese)
- Hidroizolim pa tegela dhe bashkime
- Pa shpime mbi nënshtresën metalike

ZGJIDHJA NGA SIKA

Hidroizolim tarrace/ çatie metalike me Sikalastic®-612




KËRKESAT

- Aplikimi shpejtë dhe i lehtë (aplikim direkt mbi tarracën/çatinë metalike, pa shtresë niveluese)
- Hidroizolim pa tegela dhe bashkime
- Pa shpime mbi nënshtresën metalike

ZGJIDHJA NGA SIKA

Hidroizolim tarrace/ çatie metalike me Sikalastic®-621



SISTEMI SIKA

- Sikalastic®-560 në 2 ose 3 shtresa
- Përforcim mbivendosjesh me Sika Flexistrip & Sikalastic® Flexitape të vendosura në 1 shtresë Sikalastic®-560
- Në pjesët e dala përforcim me Sika Flexistrip & Sika® Reemat Premium të vendosura në 1 shtresë Sikalastic®-560
- Sikalastic® Metal Primer ku kërkohet
- Tarracë/çati metalike


SISTEMI SIKA

- **Sipas dëshirës për reflektivitet të lartë:** Sikalastic®-570 TC ose Sikalastic®-621 TC në 1 ose 2 shtresa
- Sikalastic®-612 në 1 ose 2 shtresa
- Përforcim mbivendosjesh me Sika® Flexistrip & Sikalastic® Flexitape të vendosura në 1 shtresë Sikalastic®-612
- Në pjesët e dala përforcim me Sika® Flexistrip & Sika® Reemat Premium të vendosura në 1 shtresë Sikalastic®-612
- Sikalastic® Metal Primer ku kërkohet
- Tarracë/çati metalike

SISTEMI SIKA

- Sikalastic®-621 TC në 1 ose 2 shtresa
- Përforcim mbivendosjesh me Sika Flexistrip & Sikalastic® Flexitape të vendosura në 1 shtresë Sikalastic®-621 TC
- Në pjesët e dala përforcim me Sika Flexistrip & Sika® Reemat Premium të vendosura në 1 shtresë Sikalastic®-621 TC
- Sikalastic® Metal Primer ku kërkohet
- Tarracë/çati metalike

TARRACA/ ÇATI ME MEMBRANA BITUMINOZE EKZISTUESE



KËRKESAT

- Hidroizolim pa tegela dhe bashkime
- Me pak erë
- Pa tretës
- Rezistencë e lartë ndaj zjarrit
- Pa shpime mbi nënshtresë


ZGJIDHJA NGA SIKA

Tarraca/ çati të ftohta duke përdorur sistemet Sikalastic®-560

SISTEMET SIKA

SISTEM ME Sikalastic®-560

- 1 - 3 shtresa përfundimtare Sikalastic®-560
- Përforcim me Sikalastic® Fleece-120
- Shtresa bazë Sikalastic®-560
- Sikalastic®-560 i holluar me 10% ujë
- Membranë bituminoze ekzistuese



KËRKESAT

- Hidroizolim pa tegela dhe bashkime
- Tharje e shpejtë
- Pa shpime mbi nënshtresë
- Rezistencë e lartë ndaj zjarrit
- Reflektivitet i lartë (me përdorimin e Top Coat)


ZGJIDHJA NGA SIKA

Tarraca/ çati të ftohta duke përdorur sistemet Sikalastic®-612

SISTEMET SIKA

SISTEM ME Sikalastic®-612

- 1 - 2 shtresa Sikalastic®-570 ose 1 shtresë Sikalastic®-621 TC
- Përforcim me Sika® Reemat Premium ose Sikalastic® Fleece-120
- Prajmer Sikalastic® Metal Primer
- Membranë bituminoze ekzistuese



KËRKESAT

- Hidroizolim pa tegela dhe bashkime
- Tharje e shpejtë
- Pa shpime mbi nënshtresë
- Rezistencë e lartë ndaj zjarrit
- Mundësi dhënieje garancie të shkruar me afat deri në 20 vjet

ZGJIDHJA NGA SIKA

Tarraca/ çati të ftohta duke përdorur sistemet SikaRoof® MTC

SISTEMET SIKA

SikaRoof® MTC 15/18/22

- 1 ose 2 shtresa Sikalastic®-621 TC
- Përforcim me Sika® Reemat Premium
- Shtresa bazë me Sikalastic®-601 BC
- Prajmer Sikalastic® Metal Primer
- Membranë bituminoze ekzistuese

MODIFIKIMI I DETAJEVE ME MEMBRANAT E LËNGSHME SIKA

ZGJIDHJE EFIKASE PËR DETAJE TË NDËRLIKUARA NË TARRACA/ ÇATI

NË NJË SISTEM HIDROIZOLIMI, sidomos mbi sipërfaqet e tarracave/ çatave problemi fshihet gjithnjë tek detajet. Ekzistojnë gjithnjë detajet e vështira që mund të përbëjnë problemin për të gjithë sistemin, si nga ana e kohës për t' i përshtatur, po aq sa dhe nga ana e kostos.

PJESËT E VËSHTIRA QË DUHET TË HIDROIZOLOHEN

Edhe sipërfaqja më e madhe e një tarrace/ çatie nuk përbën një sfidë aq të madhe gjatë aplikimit të një sistemi hidroizolimi aq sa përshtatja e duhur e hidroizolimit të detajeve. Detajet janë ato pjesë që do të çojnë në dështim të mundshëm dhe konsumojnë kohën më të madhe të aplikuesve për hidroizolim e saktë të tyre, siç janë:

- Shkallë, parvaze
- Lidhje e niveleve të ndryshme dhe e formave konkrete të tarracës/ çatisë
- Vende të ngushta ku është e pamundur të kryhen punime me membrana sintetike ose bituminoze dhe me pajisje
- Piletat dhe kapërderdhësit - të cilët janë shkaku i shumicës së dështimeve dhe rrjedhjeve
- Depërtime tubacionesh

ZGJIDHJE ME MEMBRANA TË LËNGSHME SIKA

Për aplikimin e membranave të lëngshme Sika, nuk kërkohet pajisje e posaçme dhe mund të hidroizoloni tarracën/ çatinë tuaj pa asnjë tegel. Nuk nevojitet vinç ose pajisje ngritëse, pasi kovat mund të transportohen me lehtësi në vendin e punimeve, gjë që do të thotë se aksesueshmëria në tarracë/ çati nuk do të jetë kurrë një problem.

Kjo çon në produktivitet të lartë me të njëjtën fuqi punëtore, ndërprerje të kufizuar të përdorimit të tarracës/ çatisë dhe përfundim të shpejtë të punimeve.

Me përdorimin e membranave të lëngshme Sika bëhet menjëherë hidroizolimi i detajeve ku më parë ka ndodhur dështimi i sistemeve të vjetra të hidroizolimit të tarracave/ çatave, fakt që ofron kohë për programimin e rehabilitimit të plotë të hidroizolimit të tarracës/ çatisë.



MODIFIKIME TË POSAÇME DETAJESH NË SISTEMET E MEMBRANAVE SINTETIKE PËR HIDROIZOLIMIN E TARRACAVE/ ÇATAVE ME MEMBRANA TË LËNGSHME SIKA

Membranat e lëngshme Sikalastic® mund të përdoren gjithashtu në kombinim me membranat sintetike Sikaplan® dhe Sarnafil®. Sidomos për detajet e ndërlukuara dhe depërtimet, ku saldimi i membranave është procedurë e vështirë, përdorimi i membranave të lëngshme ofron një zgjidhje efikase për

hidroizolim edhe të modifikimeve më të vështira. Si prodhues membranash sintetike por edhe të lëngshme, Sika mund të ofrojë një paketë të plotë zgjidhjeje për hidroizolim, të përbërë nga produkte me pajtueshmëri të provuar, me synim sigurimin e performancës afatgjatë.


DETAJET NË MEMBRANA FPO/TPO

- 1 Nënshtrës:** membrana Sarnafil® TPO/FPO
- Pastruesi i membranës:** Sarnafil® T Clean
- 2 Prajmeri:** Sikalastic® Primer FPO (70-140 ml/m²)

DETAJET NË MEMBRANA PVC

- 1 Nënshtrës:** membrana Sarnafil® ose Sikaplan® PVC
- Pastruesi i membranës:** Sarna® Cleaner
- 2 Prajmeri:** Sikalastic® Primer PVC (70-140 ml/m²)
- 3 Shtresa e 1-rë:** Sikalastic®-621 TC (>=1l/m²)
- 4 Përforcimi:** Sika® Reemat Premium
- 5 Shtresa e 2-të:** Sikalastic®-621 TC (>=1l/m²)

- 3 Shtresa e 1-rë:** Sikalastic®-621 TC (>=1l/m²)
- 4 Përforcimi:** Sika® Reemat Premium
- 5 Shtresa e 2-të:** Sikalastic®-621 TC (>=1l/m²)



PROCEDURAT E APLIKIMIT TË MEMBRANAVE TË LËNGSHME SIKA

SIKA OFRON UDHËZIME TË DETAJUARA

për vendosjen e të gjitha sistemeve të membranave të lëngshme të gamës së saj. Në dokumentat shoqëruese që jepen, gjenden Metodën e Aplikimit dhe Udhëzimet e Instalimit, të cilat përmbajnë informacione të plota rreth të gjitha metodave të disponueshme të aplikimit dhe modifikimit të saktë të detajeve, si pjesët fundore, parapetet, etj. Këto dokumenta përmbajnë gjithashtu rekomandimet tona, lista udhëzuese për zbatimin e sigurtë të punimeve, si dhe gjithashtu procedurat e kontrollit të cilësisë.



APLIKIM ME RUL

Aplikimi bëhet në faza të ndryshme. Fillimisht aplikohet shtresa fillestare mbi nënshtresën që është modifikuar/përgatitur/pastruar saktë. Vijon vendosja e rrjetës përforcuese (p.sh. Sika® Reemat Premium) mbi shtresën bazë ende të lagësht.

Pas maturimit të shtresës bazë, aplikohet shtresa përfundimtare.

VEGLA & PAJISJE:

- Rula dhe furça

POMPË SPËRKATJEJE PA AJËR PËR MATERIALE ME 1 PËRBËRËS

Përveç aplikimit me rul, membranat e lëngshme prej poliuretani me 1 përbërës mund të aplikohen gjithashtu me pajisje spërkatjeje pa ajër. Kjo metodë përdoret për aplikim mbi çatitë metalike dhe në formë të dallgëzuar, si edhe për aplikimin e shtresave përfundimtare tek sistemet Sikalastic® për hidroizolim në përgjithësi.

PAJISJA:

Pajisja duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme:


Presioni minimal: 220 bar

Prurja minimale: 5,1 lt/minutë

Diametri minimal i majës: 0,83mm (0,033 inch)

Për shembull:



- Wagner Heavycoat HC 940 E-SSP Spraypack
- Graco Mark-X
- Larius Thor



PRODUKTE / VEGLA NDIHMUESE

PRAJMERA

<p>Sika® Concrete Primer</p>	<p>Prajmer hibrid poliureje/poliuretani me 2 përbërës, tharje të shpejtë, përmbajtje të lartë solidesh për nënshtresa me bazë çimentoje</p>
	<p>Karakteristikat</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Tharje e shpejtë - është i mundur mbulimi pas 30 minutash ■ Redukton ndjeshëm mundësinë e degazimit nga nënshtresat me rezistencë të reduktuar ■ Stabilizon nënshtresat e pluhurosura dhe të shkrifëta ■ Aplikim i lehtë me furçë ose rul <p>Ambalazhi (A+B)</p> <p>Set 11,5 L (~11,78 kg)</p>
<p>Sika® Bonding Primer</p>	<p>Prajmer epoksid me 2 përbërës dhe me bazë uji për nënshtresa me bazë çimentoje dhe veshje me bazë uji</p>
	<p>Karakteristikat</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Tharje e shpejtë - është i mundur mbulimi pas 1-2 orësh ■ Produkt pa erë dhe me bazë uji ■ Stabilizon nënshtresat e pluhurosura dhe të shkrifëta ■ Ofron absorbueshmëri të njëtrajtshme nënshtresave ■ Përmirëson ndërkapjen mbi shumë lloje nënshtresash ■ Aplikim i lehtë me furçë ose rul <p>Ambalazhi (A+B)</p> <p>Set 5,0 L (~5,16 kg)</p>
<p>Sikalastic® Metal Primer</p>	<p>Prajmer epoksid me 2 përbërës për nënshtresa metalike dhe bituminoze</p>
	<p>Karakteristikat</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Tharje e shpejtë - është i mundur mbulimi pas 6 orësh ■ Mbrojtje kundër korrodimit në mjedis industrial dhe detar ■ Aplikim i lehtë me furçë ose rul ■ Përmirëson ndërkapjen mbi shumë lloje nënshtresash metalike ■ Mbron kundër rrjedhjes së fluorëve dhe plastifikatorëve nga nënshtresat bituminoze <p>Ambalazhi (A+B)</p> <p>Set 5,0 L (~7,17 kg)</p>
<p>Sika® Reactivation Primer</p>	<p>Prajmer me 1 përbërës për aktivizimin e sistemeve ekzistuese Sikalastic® MTC</p>
	<p>Karakteristikat</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ 1 përbërës, gati për përdorim ■ Përforcon ndërkapjen mbi sistemet ekzistuese Sikalastic® ■ Mundëson aplikim e shtesave shtesë kur është tejkaluar koha e lejuar e pritjes ndërmjet shtesave ■ I përshtatshëm për aplikim mbi shumë lloje membranash ekzistuese prej poliuretani për hidroizolimim e tarracave/ çative (pasi të jetë testuar më parë ngjitja) <p>Ambalazhi</p> <p>Set 5,0 L (~5,15 kg)</p>

<p>Sikalastic® Primer PVC</p>	<p>Prajmer poliuretani me 1 përbërës për membranat Sikaplan® dhe Sarnafil® PVC</p>
	<p>Karakteristikat</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ 1 përbërës, gati për përdorim ■ Përforcon ndërkapjen mbi membranat PVC ■ Tharje e shpejtë - mbulimi është i mundur pas max. 2 orësh <p>Ambalazhi</p> <p>Shishe 1,0 L</p>
<p>Sikalastic® Primer FPO</p>	<p>Prajmer poliuretani me 1 përbërës për membranat Sikaplan® dhe Sarnafil® FPO</p>
	<p>Karakteristikat</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ 1 përbërës, gati për përdorim ■ Përforcon ndërkapjen mbi membranat ■ Tharje e shpejtë - mbulimi është i mundur pas max. 1 ore <p>Ambalazhi</p> <p>Shishe 1,0 L</p>
<p>SikaColor®-500 W Primer</p>	<p>Prajmer akrilik me 1 përbërës dhe bazë uji</p>
	<p>Përdorimet</p> <p>Prajmer për sistemet e membranave të lëngshme akrilike Sikafill®</p> <p>Karakteristikat</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ I përshkueshëm nga avujt e ujit ■ I bën sipërfaqet të padepërtueshme nga uji ■ Produkt pa tretës dhe miqësor ndaj mjedisit ■ Aplikim i lehtë me furçë, rul ose spërkatje pa ajër <p>Ambalazhi</p> <p>Bidon 5,0 L</p>
<p>Sikagard®-552 W Aquaprimer</p>	<p>Prajmer dhe përmirësues i ndërkapjes me 1 përbërës dhe bazë uji</p>
	<p>Përdorimet</p> <p>Prajmer për nënshtresat inorganike dhe sistemet e membranave të lëngshme elastike akrilike Sikafill®</p> <p>Karakteristikat</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Përdoret si përforcues i ndërkapjes ■ I përshkueshëm nga avujt e ujit ■ Produkt pa tretës dhe miqësor ndaj mjedisit ■ Aplikim i lehtë me furçë, rul ose spërkatje pa ajër <p>Ambalazhi</p> <p>Bidon 5,0 L</p>

PRODUKTE / VEGLA NDIHMUESE

SikaCor® EG-1



Veshje e ndërmjetme me 2 përbërës dhe me bazë rrëshire epokside për mbrojtje kundër korrozimit

Përdorimet

Prajmer për sipërfaqet metalike për sistemet e membranave të lëngshme elastike Sikagard® -570 W Pele Elástica® + Fibras & Sikalastic®-612

Karakteristikat

- Përdoret për përmirësimin e ndërkapjes
- Ndërkapje e shkëlqyer mbi çelik të galvanizuar me metodën e nxehtë, çelik të veshur me zink ose çelik të pandryshkshëm dhe alumin
- Mbrojtje shumë e mirë ndaj korrozimit
- Rezistencë e lartë ndaj shokut dhe tronditjeve
- Aplikim i lehtë me furçë, rul ose spërkatje

Ambalazhi (A+B)

Set 30kg

SikaFloor®-161



Prajmer me 2 përbërës dhe bazë rrëshire epokside

Përdorimet

Prajmer për sipërfaqet me bazë çimentoje dhe llaçesh epokside për sistemet e membranave të lëngshme elastike Sikalastic®-612

Karakteristikat

- Ndërkapje e shkëlqyer
- Rezistencë ndaj nënshtresave me lagështi të lartë
- Viskozitetin i ulët
- Mundësi depërtimi shumë e mirë
- Kohë të shkurtëra pritjeje
- Aplikim i lehtë me furçë, rul ose shpatull gome

Ambalazhi (A+B)

Set 30kg

SHTRESA PËRFUNDIMTARE MBROJTËSE

Sikalastic®-570 TC



Membranë e lëngshme me performancë të lartë dhe me bazë poliuretani

Përdorimet

- Shtresë përfundimtare për sistemet MTC

Karakteristikat

- Qëndrueshmëri e lartë ngjyre / nuk zverdhet (rezistencë ndaj UV)
- Reflektivitet i lartë
- Disponohet në ngjyrë të bardhë
- E përshkueshme nga avujt e ujit
- Rezistencë e lartë ndaj kimikateve të zakonshme të atmosferës
- Pa erë
- Plotëson kërkesat e LEED EQ Credit 4.2, SS Credit 7.2
- Ekonomik

Ambalazhi

Kovë 15,0L (~18,45kg)

Sikalastic®-621 TC



Membranë e lëngshme poliuretani me performancë të shkëlqyer

Përdorimet

- Shtresa përfundimtare e sistemeve MTC
- Për tarraca të ndërlikuara dhe akses të kufizuar

Karakteristikat

- Teknologji maturimi MTC
- Qëndrueshmëri e lartë ngjyre / nuk zverdhet (rezistencë ndaj UV)
- Reflektivitet i lartë
- Disponohet në ngjyra të ndryshme
- Elasticitetin e lartë me mundësi mbylljeje të plasaritjeve
- Rezistencë e lartë ndaj depërtimit të rrënjëve
- E përshkueshme nga avujt e ujit
- Sipas ETAG 005, ETA 09/0139
- Rezistencë e lartë ndaj kimikateve të zakonshme të atmosferës

Ambalazhi

Kovë 15,0L (~21,6kg)

PRODUKTE / VEGLA NDIHMUESE

PËRFORCUES



Sika® Reemat Premium

Rrjetë fibrash qelqi për përforcimin e sistemeve të membranave të lëngshme Sikalastic®.



Sikalastic® Fleece-120

Pëlhurë poliesteri për përforcimin e sistemeve të membranave të lëngshme Sikalastic®.



Sika® Flexitape Heavy

Shirit fleksibël i thurur me bazë poliamidi për përforcim lokal të sistemeve të membranave të lëngshme Sikalastic® (p.sh. në fuga ose veshje në tarraca/çati metalike)

TË TJERA



Sikalastic® Flexistrip

Shirit hidroizolues i modifikuar me veshje mbrojtëse për t' u përdorur për ndërprerjen e ndërkapjes në sistemet e membranave të lëngshme Sikalastic® (p.sh. në fuga ose veshje në tarraca/çati metalike)



Sika® PU Accelerator

Produkt i posaçëm për përsheptimin e maturimit të produkteve Sikalastic® me synim aplikimin më të shpejtë dhe shkurtimin e kohës së humbur ose në rast se kërkohet rivendosje e shpejtë në funksionim.



REFERENCA PROJEKTESH



BANESË PRIVATE, SARANDË, SHQIPËRI

HIDROIZOLIM TARRACE ME Sikalastic®-612 & Sika® Reemat Premium

PËRSHKRIMI I PROJEKTI

Projekti përfshinte restaurimin dhe hidroizolim të një tarrace me sipërfaqe 140m² të një banese private në Sarandë (Shqipëri e Jugut). Nënshtrësja ekzistuese ishte prej pllakash qeramike. Të gjitha pllakat u hoqën dhe nënshtrësja u rinovua plotësisht duke derdhur Ilaç çimentoje.

KËRKESAT E PROJEKTI

Aplikuesi kërkoi një sistem hidroizolimi me përgatitje minimale, pajisje specifike dhe aplikim të lehtë tek të gjitha detajet e ndërlikuara, duke qënë në të njëjtën kohë një zgjidhje ekonomike. Pronari kërkoi një zgjidhje afatgjatë dhe me kërkesa minimale për mirëmbajtje.

ZGJIDHJA NGA SIKA

Duke patur në konsideratë parametrat e mësipërm, sistemi i propozuar dhe i zgjedhur në fund ishte membrana e lëngshme Sikalastic®-612, e përforcuar me rrjetë fibrash qelqi Sika® Reemat Premium. Sikalastic®-612 është një membranë e lëngshme, aplikimi me metodën e ftohtë, poliuretani dhe 1 përbërësi që nuk kërkon përzjerje dhe është gati për përdorim. Produkti aplikohet shumë lehtësisht, pa nevojën e pajisjeve specifike dhe është një zgjidhje ekonomike, veçanërisht për rastet e projekteve të restaurimit.

Fillimisht, u bë përgatitja e nënshtrësës me anë të pastrimit dhe heqjes së kores së çimentos, pluhurit dhe grimcave të lira. Gjithashtu, të gjitha fugat e ndërimit dhe lëvizjes u përgatitën (me pastrim dhe izolim) në mënyrën e duhur.

Pas kësaj procedure u përzgjedh Sikalastic®-612 në ngjyrë të bardhë për të shërbyer gjithashtu si një veshje reflektive për tarracën me efikasitet energjetik dhe u aplikua mbi të gjithë sipërfaqen në dy shtresa. Midis dy shtresave të Sikalastic®-612 dhe në të gjithë perimetrin e zonës si dhe tek fugat e ndërimit, u aplikua rrjeta me fibra qelqi Sika® Reemat Premium për përforcimin e shtresave dhe pjesëve thelbësore të sistemit të hidroizolimit.



KOMPLEKS HOTELESH, MAURITIUS

RESTAURIM I HIDROIZOLIMIT TË TARRACËS EKZISTUESE ME Sikalastic®-612 & Sikalastic®-570 TC

PËRSHKRIMI I PROJEKTI

Kompleksi i hoteleve Constance Belle Mare Plage Hotel gjendet në Mauritius dhe është si një paradise mbi tokë me 104 dhoma, 149 suite Junior, 6 suite Deluxe, 18 vila private dhe vilë prezidenciale. Në vitin 2016 u vendos rehabilitimi i tarracës me sipërfaqe 8.000m².

KËRKESAT E PROJEKTI

Tarraca ishte e veshur me membrana bituminoze. Standardi për sistemin e ri të hidroizolimit ishte adaptimi i sistemit që aplikohet me metodën e ftohtë, mbi shtresën ekzistuese, duke shmangur përdorimin e zjarrit gjatë aplikimit. Gjithashtu, pati kërkesë nga ana e pronarit për një zgjidhje e cila kufizon konsumimin energjetik të ndërtesës, pasi membranat e zeza bituminoze akumulonin nxehtësi, duke ngrohur së tepërmi konstruksionin gjatë muajve të verës.

ZGJIDHJA NGA SIKA

Si sistemi për hidroizolim më efikas, rezistent, i sigurt dhe me aplikim të shpejtë u përzgjedh sistemi me membranë të lëngshme Sikalastic®-612, i përforcuar me rrjetë fibrash qelqi Sika® Reemat Premium dhe me shtresë përfundimtare Sikalastic®-570 TC. Sikalastic®-612 i kombinuar me përforcimin, krijoi një veshje plotësisht të padepërtueshme dhe pa tegela. Me synim rritjen dhe ruajtjen në nivele të larta të reflektivitetit diellor të tarracës, u aplikua një shtresë Sikalastic®-570 TC, që ka indeks tepër të lartë reflektiviteti diellor (SRI) 108. Falë kësaj vetie si dhe ngjyrës së bardhë të saj, krijon një sipërfaqe të freskët tarrace që reflekton me efikasitet dritën diellore. Duke patur si të dhënë klimën e nxehtë të Mauritius dhe duke e krahasuar me membranat bituminoze të ngjyrës së errët, sistemi i ri reduktoi ndjeshëm temperaturën në mjedisin e brendshëm dhe si pasojë kontribuoi në kursimin e konsumimit të energjisë për të gjithë ndërtesën. Falë këtyre vetive, brenda tre vitesh do të amortizohet kostoja e rehabilitimit të tarracës me anë të përfundimit nga kursimi i energjisë.



TARRACA E QENDRËS ARTISTIKE TATE BRITAIN, LONDËR

RESTAURIM I HIDROIZOLIMIT TË ÇATISË EKZISTUESE ME SikaRoof® MTC-22

PËRSHKRIMI I PROJEKTI

Galeria Tate Britain është e njohur në mbarë botën dhe bën pjesë në rrjetin e galerive britanike Tate. Ndodhet në zonën Millbank të Londrës dhe është galeria më e vjetër e rrjetit Tate, inagurimi i së cilës u krye në vitin 1897.

KËRKESAT E PROJEKTI

Për çatinë ishin vendosur kërkesa shumë sfiduese në aspektin e hidroizolimit, për shkak të detajeve të vështira të shtresave ekzistuese prej plumbi, duke kërkuar aplikimin e një produkti rezistent ndaj nxehtësisë dhe shformimeve të larta termike, duke ruajtur njëkohësisht nivel të lartë padepërtueshmërie nga uji.

ZGJIDHJA NGA SIKA

Sistemi SikaRoof® MTC-22 ishte zgjidhja optimale për një çati me strukturë kaq të ndërlikuar. Përbëhet nga një membranë e lëngshme që aplikohet me metodën e ftohtë, e cila maturohet duke formuar një shtresë elastike të padepërtueshme nga uji. Nuk ka tegela apo bashkime dhe mund të aplikohet me lehtësi dhe shpejtësi edhe në perimetër të detajeve të ndërlikuara. Pasi është aplikuar plotëson kërkesat më të larta të klasifikimit për rezistencë ndaj zjarrit për sistemet e hidroizolimit të çatave/tarracave. Avantazhi shtesë ishte arritja e njëtrajtshmërisë së ngjyrës, pasi ngjyra e membranës ishte e ngjashme me çatinë prej plumbi, duke siguruar kështu një rezultat të shkëlqyer nga ana estetike.



KOMPLEKS BANESASH TIJANI UKAY, KUALA LUMPUR, MALAJZI

RESTAURIM I HIDROIZOLIMIT TË TARRACËS EKZISTUESE ME Sikalastic®-560

PËRSHKRIMI I PROJEKTI

Kompleksi i banesave Tijani Ukay përfundoi në dhjetor të 2015 dhe përbëhet nga 118 banesa luksoze në zonën Ampang të Kuala Lumpur.

KËRKESAT E PROJEKTI

Në tetor të 2014 u vendos çështja për hidroizolim të tarracës me sipërfaqe 18.000 m² në total (tarracat kryesore dhe ballkonet). Sistemi duhet të ishte me kosto efikase, i lehtë në aplikim, elastik dhe me nivel të lartë estetik.

Sistemet e membranave të lëngshme të Sika-s disponohen në shumëllojshmëri ngjyrash dhe mund të përbushin kërkesa e dizajnit dhe ngjyrës. Janë posaçërisht të përshtatshme për tarracat e pjerrëta, pasi krijojnë një shtresë përfundimtare pa tegela dhe bashkime. Për hidroizolim të të gjitha tarracave u kërkuar një membranë e lëngshme hibride dhe me bazë uji, që mund të aplikohet në tarraca me pjerrësi minimale 3%.

ZGJIDHJA NGA SIKA

Sikalastic®-560 është membranë e lëngshme akrilike me 1 përbërës, e modifikuar me poliuretan dhe bazohet në teknologjinë CET® (Teknologjia Ko-Elastike) të Sika-s. Membrana Sikalastic®-560 është gati për përdorim, ka elasticitet të lartë dhe rezistencë ndaj rrezatimit UV. Shtresa e parë (prajmeri) e Sikalastic®-560 u aplikua e holluar me 10% ujë dhe dy shtresa Sikalastic®-560, pjesërisht të përforcuara me rrjetë prej fibrash qelqi Sika® Reemat Premium.

Skano për Sika at Work



REFERENCA PROJEKTESH

AUTO MARIN, NJËSI SHITJESH AUTOVETURASH

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Kjo njësi e re shitjesh autoveturash ndodhet në kilometrin e 23-të të rrugës nacionale Athinë -Selanik, në Agios Stefanos të Atikës. Ndërtimi i saj përfundoi në 2009. Ndërtesa ka një mjedis prej 8.000 m², ku përfshihen zyrat, dyqani i shitjeve dhe shërbimeve për autoveturat.

Për hidroizolimën e tarracës së ndërtesës u përdorën membrana bituminoze. Tek njëra nga tarracat, me sipërfaqe 450 m² u vu re një dështim, me rezultat hyrjen e ujit tek mjediset e zyrave.

KËRKESAT E PROJEKTIT

Pati kërkesë për aplikimin e një sistemi:

- Me aftësi të mbyllë plasaritjet
- Mbi sipërfaqen përfundimtare të tarracës (Ilaç çimentoje)
- Të aftë të përballojë kushtet klimaterike të rrethit të Atikës, ku sforcimi për shkak të rrezatimit UV është shumë i theksuar

ZGJIDHJA NGA SIKA

U aplikua sistemi Sikalastic® MTC-18, i cili kombinonte të gjithë vetitë e kërkuara të përmenduar më sipër. Mbi nënshtresën ekzistuese, u aplikua prajmeri Sika® Concrete Primer dhe në shtresën e parë të sistemit - Sikalastic®-601 BC- u vendos rrjeta prej fibrash qelqi Sika® Reemat Premium për mbylljen e plasaritjeve. Shtresa përfundimtare ishte 2x Sikalastic®-621 TC.



MAGAZINAT E JUMBO-S, THIVA

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Jumbo është një kompani plotësisht greke dhe aktivitet kryesor shitjen me pakicë të lodrave për fëmije, artikujve për bebe, artikujve të stinëve, artikujve dekorativë dhe artikujve kancelarie. Brenda 32 viteve të funksionimit të saj, kompania u shndërrua në njërin nga bizneset më të mëdha të shitjes me pakicë me 76 degë: 52 në Greqi, 9 në Bullgari, 10 në Rumani, 5 në Qipro, dhe ka përfaqësues tregtarë në Shqipëri, Maqedoni dhe Kosovë.

KËRKESAT E PROJEKTIT

Për njësinë e re të administrimit të produkteve në Thiva, u kërkuan punime restauruese të tarracës së ndërtesës ekzistuese. Në pjesën më të madhe të saj, çatia kishte formë të pjerrët dhe kishte pjesë të tejdukshme.

Kërkesat kryesore ishin:


- Dorëzim i shpejtë për përdorim (shumë detaje në tarracë)
- Aplikim mbi nënshtresën ekzistuese (membrana bituminoze të vjetra mbi pjesën më të madhe të sipërfaqes)
- Sistem me rezistencë ndaj rrezatimit UV dhe me veti reflektiviteti

ZGJIDHJA NGA SIKA

Sipërfaqja totale e tarracës ku u aplikuan sistemet e membranave të lëngshme ishte ~35.000 m². Mbi të gjithë sipërfaqen u aplikua sistemi i membranës së lëngshme Sikalastic®-612 në dy shtresa me prajmerin Sika® Bonding Primer. Tek fugat, trarët, bashkimet, sistemi Sikalastic®-612 u përforcua me Sika® Reemat Premium. Si shtresë përfundimtare për shtimin e qëndrueshmërisë së sistemit dhe për krijimin e një sipërfaqeje me reflektivitet të përhershëm u aplikua Sikalastic®-621 TC.



PREZENCË GLOBALE - BASHKËPUNIM LOKAL



SIKA ALBANIA SHPK

Sika AG u themelua në 1910 më seli në Zvicër dhe është një kompani lëndësh kimike të posaçme me pozicion kryesues në zhvillimin dhe prodhimin e sistemeve dhe produkteve për ngjitje, izolim, hidroizolim, përforcim dhe mbrojtje në sektorin e ndërtimit dhe industrinë e mjeteve motorike të transportit. Linjat e produkteve të Sika-s përmbajnë aditivë betoni, llaçe, izolues dhe adezivë, sisteme përforcimi të strukturës, dysheme industriale si dhe gjithashtu sisteme për tarracat/çatitë dhe hidroizolimi.

Sika Albania u themelua në 2014. Që atëherë është kthyer në zgjedhjen e parë të inxhinierit/ndërtuesit. Sjellja në treg e materialeve inovative, cilësia e garantuar e produkteve të saj & suporti teknik që ofron janë karakteristikat kryesore që e dallojnë. **Sika Albania**, falë njohurive të saj teknike ka asistuar në ndërtimin e disa projekteve kryesore në vend gjatë viteve të fundit. Bashkëpunimi i ngushtë me sektorin teknik dhe tregtar mundëson transferimin e kësaj teknologjie në të gjithë Shqipërinë, deri në kantierin më të largët.

Ju lutemi lexoni skedën teknike të produktit përkatës përpara përdorimit.



alb.sika.com



Sika Albania YouTube Channel



Sika Product Finder

© Sika Albania SHPK / ROOFING / 022020

SIKA ALBANIA SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, Kati 3
Tiranë, Shqipëri

Na kontaktoni

Telefon: +355 4 454 0070
Email: info@al.sika.com
Website: alb.sika.com

BUILDING TRUST

